

**MENDIME MBI PROJEKTLIGJIN "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN  
SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË  
FAKULTETIT TË DATËS 29.01.2015**

Në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit të datës 29.01.2015 me rend dite diksutimin e projektligjit "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë" u paraqitën mendimet e mëposhtme:

Ky projektligj ka disa probleme krahasuar me ligjin paraardhës pasi nuk del qartë kush është autoriteti dhe përfaqësuesi i institucionit të arsimit të lartë. Ky projektligj ka dy koka: Rektorin dhe Administratorin.

Në lidhje me Statutin thuhet se hartohet nga Senati Akademik dhe Administratori dhe miratohet nga Bordi i Administrimit, në të cilin pjesa më e madhe e anëtarëve janë nga Ministria. Statuti duhet të miratohet vetëm nga Senati Akademik dhe më pas të kalojë në hierarkitë përkatëse.

Në projektligj i jepen shumë kompetenca Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë, gjë që cënon autonominë e institucioneve të arsimit të lartë. Ky projektligj do të krijojë shumë probleme në rast se për çdo gjë do të autorizohet Ministria.

Në projektligj përmenden shumë agjenci ku nuk kuptohet mirë roli i tyre.

Në lidhje me strukturën e universiteteve nuk del mirë roli i secilës strukturë (Rektor, Dekan, Përgjegjës Departamenti). Vërtet disa kompetenca i kalojnë departamentit por finalizimi i tyre mbetet i paqartë. Si do komunikojë departamenti me drejtuesit më lart? Dekani nuk përmendet pothuajse fare.

Në projektligj flitet për një Asamble Akadematike por nuk thuhet kush e drejton dhe është hequr Këshilli i Fakultetit. Asambleja sipas ligjit ka disa detyra specifike si emërimin e Rektorit dhe Drejtuesit të njësisë bazë, por nuk ka rol tjetër.

Në piramidën e organizimit të personelit ndihmës-mësimor nuk del qartë roli, duhet të jetë më i qartë dhe i kuptueshëm pasi ne jemi fakulteti që prekemi më shumë.

Ky ligj na kthen në kohë kur çdo gjë kalon në varësi të shtetit, duke cënuar autonominë e institucioneve të arsimit të lartë. Në momentin që futet shteti në kontrollin e universiteteve nuk ka më univeristete të lira.

Ky ligj heq të drejtën e studentëve për të votuar për zgjedhjen e Rektorit dhe të Dekanit, heq të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar në strukturat e fakulteteve.

Ligji vërtet i jep autonomi më të madhe njësisë bazë, departamentit, por në rangje më të larta është vetëm shteti. Shteti mesa duket në nimsat që ka marrë do të fusi në kupolën e kontrollit si institucionet publike dhe ato private. Nuk duhet lejuar që shteti të fusi duart në autonominë e universiteteve dhe mirëfunksionimin e tyre.

Me këtë ligj do të ndodhë që një pjesë e institucioneve private të kalojnë në publik të pavarur, pra do futen në buxhetin e shtetit, ku arka e shtetit për kërkim shkencor dhe mësimdhënie do të ndahet midis të gjithëve. Fryma e projektligjit çon në cenatralizim të sistemit. Në ligj futet dhe koncepti i institucionit të pavarur duke rritur riskun e integritetit të universiteteve jopublike. Në hartimin e projektligjit duke qartë ndikimi i përfaqësuesve të institucioneve private.

Në ligj parashikohet (neni 144, pika 3) që fitimi i titujve akademikë bëhet jo më herët se një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji, gjë që do sillte ngrirje për një periudhë të gjatë kohore.